



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI

SHOQATA E ARTISTËVE TË RINJ TË  
SKENËS

Nr. 2007 Prot, datë 29.05.2012

Nr. — Prot, datë 29.05.2012

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Dhe

SHOQATËS SË ARTISTËVE TË RINJ TË SKENËS

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIM**, si institucion shtetëror i cili funksionon në bazë të ligjit Nr. 10 221, datë 14.02.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, që këtu e më poshtë do të referohet si Komisioneri (Pala);

dhe

**SHOQATA E ARTISTEVE TË RINJ TË SKENËS**, organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse, që këtu e më poshtë do të referohet si, SHARS (Pala);

përpilojnë këtë dokument, për të vërtetuar bashkëpunimin në Projektin: *“Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimit të zbatimit të legjislacionit dhe politikave anti-diskriminim per popullsine Rome, Egjiptiane dhe personat me aftesi të kufizuara tek te rinjte e Shkollave te mesme ne rrethin e Fierit, ne qytetet Levan, Patos, Roskovec me anen e Fotonoveles.”*

Shoqata e Artistëve të Rinj të Skenës SHARS, do të aplikojë pranë Fondacionit “SOROS” për Projektin: *“Rritja e ndërgjegjësimit dhe promovimit të zbatimit të legjislacionit dhe politikave anti-diskriminim per popullsine Rome, Egjiptiane dhe personat me aftesi te kufizuara tek te rinjte e Shkollave te mesme ne rrethin e Fierit, ne qytetet Levan, Patos, Roskovec me anen e Fotonoveles.”*

Palët,

Bien dakort si më poshtë vijon:

**Detyrimet e Shoqatës së Artistëve të Rinj të Skenës, SHARS:**

1. Shoqata merr përsipër të realizojë projektin sipas kushteve të vendosura në aplikimin pranë Fondacionit "SOROS" dhe të përgjigjet për të gjitha procedurat financiare dhe juridike në realizimin e këtij projekti.
2. Shoqata do të mbajë në korrent të zhvillimit të projektit Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
3. Në kuadër të këtij projekti, SHARS do t'i kalojë Zyrës së Komisionerit të gjitha ankesat për diskriminim që do të mblidhen gjatë procesit të projektit.

**Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi do të jetë bashkëpuntor me SHARS në këto pika:**

1. Komisioneri do të caktojë dhe do të dërgojë një përfaqësues në forumet e organizuara nga SHARS në funksion të projektit.
2. Komisioneri do të trajnojë dhe do t'i njohë në mënyrë profesionale me Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", specialistët që do të marrin pjesë në projekt dhe që janë staf i SHARS dhe bashkëpuntorëve të kësaj organizate.
3. Komisioneri do të vërë në dispozicion të projektit të gjitha adresat, postare apo elektronike, si dhe numrat e telefonit që disponon për këtë qëllim. Këto adresa dhe numra telefoni do të reklamohen nga SHARS gjatë realizimit të projektit ndërmjet target grupeve të përcaktuara në projekt.
4. Komisioneri do të mbajë kontakte të vazhdueshme me SHARS, për të tërhequr nga organizata, ankesat që do të hidhen në kutitë e ankimit nga të rinjtë e shkollave ku do të vendosen këto kuti.

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN  
NGA DISKRIMINIMI**

**SHOQATA E ARTISTËVE TË RINJ TË  
SKENËS**



**GJERGJI TROLA**

**KRYETARI**